



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1078_12_13**;
- Ankesa e KEDS-it e datës 17.01.2014.

në seancën e mbajtur më datë 12 mars 2014, nxorri këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e KEDS-it ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin O.C. (parashtruesi i ankesës B.K. me shifër të konsumatorit: DPR – 90075608) nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1078_12_13 i datës 23.12.2013

Arsyetim

Me datë 09.11.2011 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për instalimin dhe pranimin e njehsorit elektrik kanë dalur te konsumatori dhe kanë bërë regjistrimin e njehsorit elektrik nr. 47486331 me gjendje: TL=7 kW dhe TU=3 kW.

Me datë 09.11.2011 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë dalur te konsumatori për të inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë konstatuar se njehsori elektrik i cili është pranuar është për harxhim të përbashkët të objektit dhe se figuron në listën e përpiluar si njehsor i regjistruar më parë, mirëpo njehsorin e kemi bllobuar.

Me datë 03.07.2013 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë dalur te konsumatori për të inspektuar pikën matëse të konsumatorit me shifër DPR – 90075608 dhe se gjatë inspektimit kanë konstatuar se njehsori elektrik nr. 47486331 është me matje gjysëmindirekte dhe se duhet t'i caktohet konstanta e tij andaj kërkojmë nga ekipet e matjes që urgjent të vizitojnë pikën matëse për kontrollim dhe shqyrtim të tij.

Me datë 05.07.2013 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë dalur te konsumatori për të inspektuar pikën matëse të konsumatorit me shifër DPR – 90075608 dhe se gjatë inspektimit kanë konstatuar se është bërë kontrollimi i pikës matëse dhe se njehsori elektrik nr. 47486331 mat energjinë elektrike të përbashkët i cili ka TMRR 250/5 pra duhet me qenë konstanta 50, si dhe janë kufizuar tensionet dhe janë blloku TMRR ekzistues. Po ashtu punëtorët e autorizuar kanë theksuar se konsumatori duhet të bëjë kërkesë për pëlqim elektroenergjetik shtesë për këtë pikë matëse në afat prej tre diteve në të kundërtën do të shkyçeni nga rrjeti elektrik.



Me datë 05.09.2013 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë dalur te konsumatori për të inspektuar pikën matëse të konsumatorit me shifër DPR – 90075608 dhe se te grupi matës i demontuar kanë evidentuar njehsorin elektrik nr. 47486331 dhe se me konstante C=50 dhe se po ashtu është theksuar se energjia e harxhuar të llogaritet me konstante. Ndërsa te pjesa e grupit matës të montuar është evidentuar njehsori elektrik nr. 47486331 me konstantë C=10 dhe se po ashtu është theksuar se energjia e harxhuar deri ne gjendjen: TL=01414.560 kW dhe TU=00471.527 të llogaritet me konstante 50/5.

Me datë 05.10.2013 Departamenti i Faturimit në KKDFE ka lëshuar urdhër lejimin/ngarkimin nr. 56081 në vlerë prej 4,843.41€, me datë 05.10.2013 ka lëshuar urdhër lejimin/ngarkimin tjetër nr. 56082 në vlerë prej 965.23€, dhe se prapë me datë 05.10.2013 ka lëshuar urdhër lejimin/ngarkimin nr. 560813 në vlerë prej 1,732.17€. Pra, me datë 05.10.2013 Departamenti i Faturimit në KKDFE gjithsej e ka ngarkuar konsumatorin në vlerë prej 7540.81€.

Pas kësaj konsumatori me datë 18.10.2013 ka kundërshtuar ngarkesat e bëra nga KEDS-i të datës 05.10.2013 si të pabaza dhe të parregullta në lartësi prej 7540.81€. Departamenti për Konsumator në KKDFE me datë 24.10.2013 i është përgjigjur konsumatorit me shifër DPR – 90075608 duke e evidentuar përgjigjen e tyre si aprovim por në arsyetim theksohet se korrigjim apo ngarkimi nr. 56081, 56802 dhe 56803 i datës 05.10.2013 është bërë sipas procesit nr. 019682 të datës 05.09.2013, ku faturat nga periudha 02/2012 e deri më 07/2013 janë llogaritur me konstante C=50.

Konsumatori pas marrjes së përgjigjes së KEK-ut me datë 19.11.2013 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. DMK pas parashtrimit të ankesës së konsumatorit ka bërë shqyrtimin e ankesës dhe me datë 23.12.2013 ka nxjerr vendim duke e **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KKDFE që: i) të shkarkon shifrën DPR – 90075608 nga ngarkesat/korrigjimet nr. 56081 në vlerë prej 4843.41€, nr. 56082 në vlerë prej 965.23 dhe nr. 56083 në vlerë prej 1732.17€ të datës 05.10.2013; dhe ii) të kalkulon korrigjimin dhe ta ngarkoj konsumatorin me shifër DPR – 90075608 me konstanta C=50 nga periudha e procesverbalit nr. 0246834 të datës 03.07.2013 e deri më procesverbalin e montimit të grupit matës nr. 019682 e datës 05.09.2013

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 17.01.2014 KEDS-i ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes dhe zbatimit të gabuar të dispozitave ligjore.

Baza e kundërshtimeve të KEDS-it të theksuara në ankesë është se njehsori elektrik nr. 47486331 që nga fillimi prej 02/2012 ka qenë me 5A me matje gjysmëindirekte me TMRR 250/5, ndërsa ka qenë i regjistruar si matje direkte dhe se faturat deri më 08/2013 i kanë shkruar me matje direkte. Sipas KEDS-it ky ka qenë një lëshim i paqëllimshëm dhe se realisht shpenzimi i KEDS-it është dashur të jetë me C=50 andaj edhe është bërë korrigjimi i datës 05.10.2013.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 13 mars 2014 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEDS-it, përkatësisht bazën e kundërshtimit, me të cilën pretendohet se DMK, gjatë vendosjes së kësaj çështje nuk ka vlerësuar mirë provat dhe faktet e prezantuara.

Bordi i ZRRE-së pas vlerësimit të shkresave të lëndës ka vërejtur se në procesin e pranimit të instalimit elektrik nr. 072251 të datës 09.11.2011 me të cilën është bërë pranimi/regjistrimi i njehsorit elektrik nr. 47486331, punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë evidentuar se njehsori është i regjistruar si konsumator i grupit tarifar amvisëri (shtëpiak) apo i grupit tarifar 5, si dhe kanë evidentuar se këtu kemi të bëjmë me njehsor i përbashkët. Përveç kësaj në procesverbal është theksuar se ekziston edhe pëlqimi elektroenergjetik, dhe se nuk potencuar se kemi të bëjmë me grup matës. Po ashtu në procesverbalin e KEK-ut nr. 1243752 të datës 09.11.2011 Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se në procesverbal është konstatuar se njehsori elektrik nr. 47486331 i cili është pranuar për harxhim të përbashkët të objektit nuk figuron në listën e përpiluar i cili është dhanë më parë, andaj edhe njehsorin e kemi bllobuar.



Pretendimi i KEDS-it se njehsori elektrik i konsumatorit nr. 47486331 që nga fillimi ka qenë me 5A me matje gjysëmndirekte e me TMRR 250/5, por që për shkak të lëshimeve të punëtorëve fatura e parë me konstante i ka shkuar në muajin 08/2013, është i pasaktë ngase punëtorët e autorizuar të KEK-ut e kanë bërë vet pranimin/regjistrimin e këtij njehsori si konsumator i grupit tarifor konsumatorit i grupit tarifor 5 (4/02) dhe pa konstanta llogaritëse, madje tek pas 21 muajve (datë 03.07.2013, 05.07.2013) kanë konstatuar se tani kemi grup matëse dhe se duhet t'i caktohet konstanta llogaritëse. Ndërsa tek me datë 05.09.2013 punëtorët e KEDS-it kanë gjatë montimit dhe demontimit të grupit matës kanë konstatuar se e tërë energjia e regjistruar në njehsorin elektrik nr. 47486331 duhet të llogaritet me konstante C=50. Po ashtu Bordi i ZRRE-së thekson se punëtorët e autorizuar të KEK-ut (tani KEDS) e kanë obligim ligjor sipas Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji dhe procedurës së leximit dhe faturimit të vizitojnë çdo muaj pikën matëse me qëllim të marrjes së gjendjes së shpenzuar në njehsorin elektrik dhe është e pamundur se si për 21 muaj të mos e evidentojnë punëtorët e autorizuar se njehsori kinse ka pasur edhe grup matës (konstante llogaritëse).

Sipas listave të leximit të KEK-ut (tani KEDS) prej periudhës 03/2012 – 08/2013 Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se nga periudha 03/2012 e deri më 06/2013 lexuesi ka evidentuar se gjithçka është në rregull, ndërsa në listën e leximit të periudhës 07/2013 dhe 08/2013 lexuesi i KEDS-it ka evidentuar se njehsori elektrik duhet të kontrollohet nga ekipet e inspektimit. Sipas këtyre listave të leximit nuk vërehet kjo shifër e konsumatorit është grup matës.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KKDFE në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 13.03.2014 ka analizuar ankesën e KEDS dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1078_12_13, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar